



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-2596 dt. 16/01 2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
24.12.2025

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi Kuvendit Komunal: Burim Bujupi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarët e kuvendit të komunës.

Në mbledhje munguan Zeqir Hasi dhe Erblinë Morina

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

Rend dite:

1. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
2. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.
3. Plani i punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026.
4. Plani i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026.
5. Plani Lokal i veprimit në mjedis 2025-2029.
6. Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit – Komuna e Drenasit 2025-2029.
7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.
8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Glllogocit 2026–2029
9. Plani i Reagimit Emergjent (PRE) për Komunën e Glllogocit.
10. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
11. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025.
12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026.

13. Raporti i vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve të Komunës së Drenasit për vitin 2025.
14. Raporti Financiar Janar-Shtator 2025.
15. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025
16. Diskutimi i Raportit të Përformancës Komunale për vitin 2024.

Prezent gjatë mbledhjes ishin 25 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci si dhe stafi i kryetarit.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi pasi prezantoi rëndin e ditës fjalën e merr:

Ezona Terdevci, faleminderit kryesues merr si përgjegjësi që prej detyrave të para me qenë rregullimi i mikrofonave në sallën e kuvendit komunal, e pata një diskutim të shkurtër të pika e dytë e kemi fol edhe në seancën e kaluar përfaqësuesi nga komiteti për komunitete duhet me qenë kryetari i këtij komiteti në KKSBB rrjedhimisht nuk është zgjedhur ende kështu që propozoj me shty ose me formu pa përfaqësuesin e komitetit për komunitete me shtua pastaj atë përfaqësues.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci kësaj mbledhje as nuk i hiqen e as nuk i shtohen pikat e rendit të ditës ligji e përcakton kush është kryesuesi në mungesë të tij kush e zëvendëson.

Driton Ajazi, është një plan voluminoz ditor dhe të gjithë kemi pasur probleme teknik me emalin zyrtar dhe si rezultat i kësaj nuk kemi pas qasje me pa materialin që janë shumë pika të rendit të ditës dhe kërkoj që disa nga këto pika të shtyhen për mbledhje të rregullt të kuvendit komunal pikat që kërkoj të shtyhen janë nga pika pesë deri të pika e nëntë.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, këto janë dokumente që duhet me i votu për shkak se këto hyjnë në grandin në performancës komunale sa i përket imellave sekretaria merr me këtë punë ,tregova edhe me herët që as nuk mund të shtojmë as të hjekum pika të rendit të ditës, mundeni me votu kundër punë e imja është me e dërgu me kohë e ju votoni si të doni.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi unë mendoj që ata të cilët kanë problem me imella munden me ju drejtu të sekretarisë dhe me u saqru me në detaje.

Pasi që me nuk pati diskutime, vërejtje apo **sugjerime kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi** hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 25 anëtar

Për votua 14 Kundër 0 Abstenim 9

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e parë të rendit të ditës1. Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete;kjo pikë ka qene edhe në mbledhjen e kalume po për shkak të mungeses se emrave nga shoqëria civile e kemi shty për sot.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, anëtarin e shoqërisë civile dhe anëtarin e komunitetit të biznesit përcakton kryetari i komunës ne i kemi dy emra por jemi të gatshem me ja jep mundësin që nëse ju keni emra për këtë komunitet jam i gatshëm me i pranu

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi faleminderit kryetar siç edhe e dini ky komitete formohet nga 5 anëtar 3 anëtar nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile dhe një nga komuniteti i biznesit vazhdojmë me propozimet .

Xhavit Drenori faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë ju urojë të gjithëve bashkërisht të bëjmë punët me të mira për qka edhe jemi deleguar këtu, kryesuesi edhe në të gjithë përbëjmë organin me të lartë që është kuvendi i komunës dhe jemi në shërbim të qytetareve në herën e kaluar patëm 5 emra ,formula ishte dy dy , një gjithmonë po i drejtohem rendit të tretë të subjekteve të tjera unë besoi që është e drejt me shku një një dhe një prapë me mbete prej pjesës të ish opozitës ose opozitës që janë grupe me të vogla me qenëse është formal nuk ka ndonjë rol shumë të madhe dhe ekzekutiv, unë mendoj që subjekti me i madh në këtë rast PDKRLL të ketë një mandat PDK një mandat dhe nga ana jonë e kemi pas Egzon Qorri dhe le të mbetet ai.

Gani Krasniqi nga PDKRLL propozojmë Edon Nishori

Driton Ajazi nga PDK propozojmë Jahir Hajdari

Arbër Halilaj propozon Egzon Qorri

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovi, ne prej ekzekutivit shoqëria civile Violet Ipshi-Bujupi dhe Imri Bajraktari, prej biznesi po e caktojmë Valentina Sejdiu d.m.th kuota gjinore po plotësohet

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi propozimet janë

Edon Nishori anëtar nga PDKRLL

Jahir Hajdari anëtar nga PDK

Egzon Qorri anëtar nga LDK

Violeta Ipshi-Bujupi anëtar nga shoqëria civile

Valentina Sejdiu anëtar nga komuniteti për biznes

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës1.

Propozim-vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete;

Për votua 24 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e dytë të rendit të

ditës2. Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Me qensë I kemi propozimete e presim edhe një anëtarë nga kuvendi me ju bashku kush do që bëhet kryesues I komitetit për komunitete e hodhim në votim pikën e dytë të rendit të ditës

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0,

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e tretë të rendit të ditës 3. Plani i punës i Kuvendit Komunal për vitin 2026;

Xhavit Drenori në diskutim me kolegën Egzonën në material i kemi marr datat që më shumë janë tentative se sa që janë fikse dhe pas diskutimit erdhëm në përfundim që mandje ndoshta është edhe pak e arsyeshme sepse mund të këtë ndonjë inpenjim kryetari ose ekzekutivi që s'mundemi me i mbajte megjithatë për neve kishte me qenë e rëndësishme që prej fillimit me u ditë datat për me u përgatiti por kjo nuk është qeshtja kryesore për të cilën dëshiroj me diskutu ky është plani i punës kuvendit që ka 27 anëtar të kuvendit ndërsa ky tjetri është plani i punës së kryetarit për kah volumi unë e kuptoi që i ka 12 drejtori, unë mendoj që brenda këtij plani ne duhet me e gjete hapësirën tonë të veprimit të kërkesave nevojave të qytetareve të cilët na kanë

mendoj që brenda këtij plani ne duhet me e gjete hapësirën tonë të veprimit për me qenë ne shërbim të kërkesave, nevojave të qytetareve të cilët na kanë delegu këtua.

Këto propozime që po i bëj brenda kësaj pikë të rendit të ditës besoi që janë të analizuara dhe nuk janë thjesht sa për një konsum me dal para jush këtu. Sipas këtij plani janë të planifikuara 11 mbledhje të rregullta dhe mbledhjet tjera që kanë me qenë solemne edhe eventualisht të jashtëzakonshme.

Si anëtarë të Kuvendit Komunal, kemi një angazhim të madh dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve. Për këtë arsye, ne kërkojmë që përveç mbledhjeve të rregullta, të mbahet edhe të paktën një mbledhje shtesë gjatë muajit tetor, ndërsa në mbledhjen e radhës të rregullt të themelojmë minimum katër komisione me anëtarë të Kuvendit Komunal. Këto komisione do të kenë mbledhje të veçanta dhe të rregullta. Nëse i formojmë këto komisione, jam i bindur se jo vetëm kryetari, i cili deri më tani ka qenë kampion në performancë, por edhe ne si Kuvend Komunal do të jemi kampionë në angazhim dhe performancë. Kjo sepse, nëse mbetemi vetëm të pikat e rendit të ditës që vijnë këtu si propozime, secili prej nesh diskuton vetëm në bazë të njohurive që kemi, sepse nuk jemi të fushës profesionale. Neve brenda materialeve na sillen dokumente nga fusha të ndryshme dhe për mua personalisht shpeshherë është e vështirë që brenda ditës të kuptojmë thelbin e tyre, pasi nuk jemi ekspertë të asaj fushe. Qëllimi ynë është gjithmonë të marrim vendimin më të mirë të mundshëm. Po e them sinqerisht: nëse i formojmë këto komisione, përveç mbledhjeve të rregullta, do të kemi edhe mbledhje shtesë. Në vitin e ardhshëm, me nga një mbledhje në gjashtëmujorin e parë dhe një në gjashtëmujorin e dytë, jam i sigurt se anëtarët e Kuvendit do të mund të aktivizohen më shumë në këto komisione, për të bërë punë të mira për qytetarët. Në nivel lokal nuk ekziston pozita dhe opozita si në nivel qendror. Kryetari zgjidhet veçmas dhe për katër vjet ne mund të pajtohemi ose jo me politikën e tij. Vetëm në rast se bëhet ndonjë gabim i madh, ligji parasheh sanksione, pasi të dyja palët jemi të deleguar nga qytetarët. Për këtë arsye propozoj që të shtohet edhe një mbledhje gjatë muajit tetor ose nëntor dhe që në mbledhjet e rregullta të themelojmë komisione për monitorimin e projekteve komunale.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, sqaron për planin e punës e përmbledh një vjeqarin e punës së kuvendit ku brenda vit duhet të mbajë 11 mbledhje ashtu edhe si e kemi paraparë po në qoftesë është nevoja debatojmë edhe në KPF dhe i japim rekomandimet tona për kuvend.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, sipas ligjit e rregulloreve janë 11 mbledhje të rregullat një muaj e keni pushim Gushtin e keni caktuar, unë detyrohem me ju përshtatë planit të juaj për pjesëmarrje në kuvend se sepse humbi pikë për grand të performancës nëse nuk marr pjesë në mbledhje dhe me marrëveshje i caktojmë datat për mbledhje.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e 3. Plani i punës i Kuvendit Komunal për vitin 2026;

Për votua 21 Kundër 0 Abstenim 2

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi, e hap për diskutim pikën e katër të rendit të ditës. 4 Plani i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026;

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Xhaviti e përmbledhi si material i voluminoz, ne e kemi 12 drejtori 7 njësi tjera komunale e kemi pas materialin 200 faqe jemi mundu me zbrit jemi mundu me e përmbledhë të gjitha.

Arbër Halilaj i përshëndet të gjithë të pranishmit dhe i dëshiron suksese dhe mendoj që janë shumë me të vogla dallimet që na ndajnë se ato që i kemi të përbashkëta kështu që besoi shumë që mund të gjejmë një gjuhë uniteti dhe angazhimi të përbashkët për atë që përfaqësojmë këtu. Plan Lokal për Veprimin në Mjedis të Komunës së Drenasit.

Ngjashëm me komunat tjera në Kosovë, edhe komuna jonë ka probleme të pazgjidhura mjedisore, që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, menaxhimin e mbeturinave, shpyllëzimin dhe shkatërrimin e biodiversitetit, florës e faunës etj.

PLVM i komunës së Drenasit është një dokument strategjik dhe obligim ligjor sipas nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, i cili Plan Lokal duhet të jetë në harmoni me Planin e Veprimit Kombëtar në Mjedis (PKVM), Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit (SKMM), Strategjinë për ndryshimet klimatike 2019- 2028 dhe dokumentet tjera që merren me mjedisin jetësor dhe përmirësimin e gjendjes së tij.

Përkundër ndërmarrjes së disa veprimeve e projekteve për përmirësimin e gjendjes, ka vazhduar degradimi i burimeve natyrore (pyjeve, tokës bujqësore, burimeve ujore, florës e faunës etj.), gjë që është shqetësuese jo vetëm për ne, por edhe për faktin se këto resurse nuk janë pronë e një gjenerate por duhet të ruhen edhe për gjeneratat pasuese.

Komuna jonë ende ka një sërë sfidash të pazgjidhura mjedisore, siç janë: trajtimi dhe menaxhimi i ujërave të ndotura, menaxhimi i mbeturinave, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe e tokës bujqësore, furnizimi me ujë të mjaftueshëm e cilësor për pije.

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (2025-2029), që e kemi sot para vetes, i cili konstaton gjendjen aktuale mjedisore, poashtu përcakton edhe prioritetet sa i përket çështjeve mjedisore në periudhën e cekur pesëvjeçare (2025-2029). Ky Plan, i bazuar edhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale, është mundësi e mirë për planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke adresuar dhe ofruar zgjidhje për problemet mjedisore në nivel lokal.

Por, disa masa e veprime shtesë , duke u mbështetur edhe në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit, mendoj se do ta plotësonin edhe më tepër këtë plan, e që do t'i theksoj në vijim:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve:

- Organizimi i fushatave edukative për qytetarët mbi rëndësinë e ruajtjes së burimeve natyrore dhe menaxhimit më të mirë të mbetjeve – është hapi i parë, që sa e kam analizuar është përfshirë në këtë PLVM, por vetëm lypset të konkretizohet në veprime dhe faza kohore.
- PROPOZIM SHITESË: Komuna dhe DKA të ngrisin çështjen e integritit të mbrojtjes mjedisore në kurrikulat shkollore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

2. Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme (PROPOZIME SHITESË)

- Duhet të Inkurajohen dhe mbështeten më tepër projektet e përdorimit të energjisë solare dhe të erës, si burime të ripërtëritshme.
- Subvencionimi i instalimit të sistemeve të ngrohjes solare në ndërtesat publike dhe private.

3. Ruajtja e biodiversitetit (PROPOZIME SHITESË)

- Ruajtja e habitatit natyror nga shkatërrimi, sidomos në vendet me potencial edhe turistik, siç është Liqeni i Vasilevës.
- Zhvillimi i projekteve për mbrojtjen e specieve të rrezikuara të florës dhe faunës.
- Implementimi i një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të biodiversitetit, duke krijuar një bazë të të dhënave për monitorimin e florës dhe faunës lokale.

- Ruajtja e habitatit natyror nga shkatërrimi, sidomos në vendet me potencial edhe turistik, siç është Liqeni i Vasilevës.

- Zhvillimi i projekteve për mbrojtjen e specieve të rrezikuara të florës dhe faunës.

- Implementimi i një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të biodiversitetit, duke krijuar një bazë të të dhënave për monitorimin e florës dhe faunës lokale.

4. Informimi publik për gjendjen mjedisore (PROPOZIME SHITESË)

- Publikimi i raporteve të rregullta periodike mbi gjendjen, ndikimet kryesore mjedisore dhe vlerësimin e propozimeve, në mënyrë që të jenë të qasshme edhe për qytetarët.

5. Menaxhimi i mbeturinave komunale (PROPOZIME SHITESË)

- Inicimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave, përmes fuqizimit të rolit të NPL “Eko-Drenasi” sh.a., me qëllimin që të fillohet me iniciativa të riciklimit dhe reduktimit të mbetjeve në burim nëpërmjet kontejnerëve të veçantë për mbeturina, sidomos për plastikën dhe metalet.

6. Përdorimi i mundësive që ofrojnë teknologjitë e reja (PROPOZIME SHITESË)

- Zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit GIS për monitorimin e mjedisit.

- Raportimi online i ndotjes dhe problemeve mjedisore, përmes krijimit të një platforme për raportimin e këtyre rasteve nga ana e qytetarëve.

7. Përfshirja e palëve të interesit

- Tek përfshirja e palëve të interesit dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile, unë propozoj që të planifikohen edhe marrëveshje bashkëpunimi me universitetet në hartimin e politikave mjedisore lokale në Komunën e Drenasit.

Plani është përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës, ndërsa propozimet e cekura mendoj se e bëjnë edhe më efikas dhe të qëndrueshëm këtë Plan Lokal për Veprimin në Mjedis të Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, gjithmonë ka vend për me e plotësu për mendime veprime me të mira ne i kemi pas dy javë ditë afat ka qenë në diskutim publik i kemi banë me kompani të eksperteve siç e kërkon ligji nuk kemi marr ndonjë komente prej juve.

Xhavit Drenori, falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në këtë raport. Dokumenti është voluminoz, mirëpo këto dy pika janë të fushës sime, konkretisht mbrojtjes së mjedisit, pa shkuar shumë larg as nga ajo që u tha nga kryetari, me datën 15.10.2025 është përgatitur nga një komision që ka punuar në hartimin e tij.

Ka përsëritje të shumta të shprehjeve dhe formulimeve, si kur me u bërë pjesë, pjesë prej dy tre katër vetëve. Ne, si anëtarë të Kuvendit Komunal dhe përfaqësues të qytetarëve, po flasim për një plan veprimi. Për ta kryer punën siç duhet, dokumenti duhet të përgatitet nga një komision funksional. Me marrjen e këtij dokumenti, dalim edhe ne në terren, sepse hedhja e mbeturinave nuk varet nga reshjet e borës apo faktorë të tjerë natyrorë, por varet nga ne. Kjo nuk është vetëm përgjegjësi e ekzekutivit, por edhe e jona si Kuvend Komunal. Ky plan është larg asaj që do të duhej të ishte një plan i mirëfilltë. Në aspektin shkencor, dokumenti ka mangësi jashtëzakonisht të mëdha, ka përsëritje dhe kundërthënie, por është voluminoz.

Me këto informacione, edhe një herë kërkoj që të krijojmë komisione funksionale dhe të jemi kampion edhe ne si Kuvend Komunal.

Sa i përket zbatueshmërisë, një pjesë e përgjegjësisë bie edhe mbi ne, nëse dëshirojmë që punët të përfundojnë si duhet.

Liman Krasniqi, sa i përket planit lokal të veprimit ne mjedis mos ti përsëris çështjet që kolegu përpara i analizoj pas një vështrimi të përgjithshëm pashë që janë propozuar edhe disa masa mbrojtëse sidomos të pompave të benzinës, kam dëshirë me me ndihmë drejtori i inspeksionit apo drejtori i urbanizmit që janë paraqit të gjitha pajisjet të cilat janë të domosdoshme për një pompë shkaku i rrezikut po askund nuk e pash që janë trajtu separatorët e derivateve edhe uljes sepse të gjithë jemi duke folur për një mbrojtje të sistemit të ujërave atmosferike dhe të ujërave fekale në aspektin profesional çdo pompë duhet me posedu separatorin e uljes që bahet ndarja edhe e derivateve edhe e uljes prej ujit atmosferik gjatë shfrytëzimit të tyre se ato ujëra derdhen në kanalizimin atmosferik dhe karakteristika e terrenit tonë si territor i komunës së Drenasit është se të gjitha ujrat atmosferike kanë renije në drejtim të lumit Drenica dhe të gjitha përcillen përmes lumit Drenica në tokat bujqësore sepse pjesa më e madhe e terrenit tonë është tokë bujqësore kërkoj një sqarim nga drejtori i inspeksionit, a kanë informata a posedojnë separatorët të uljes dhe derivateve pompave e derivateve po gjithashtu edhe drejtori i urbanizmit që lëshon leje ndërtimi, ndërsa sa i përket deponive ilegale është karakteristikë që me ardh deri të evitimi i deponive ilegale është mirë me pas edhe deponi legale siç është periudha e pas luftës që kanë dal shumë objekte të dëmtuara mirëpo edhe plani zhvillimor edhe urban ka fillu me u zgjër në sipërfaqe me të mëdha se sa ka qenë deri tani e imponon kërkesën e kompanive ndërtimore sigurisht drejtoria e urbanizmit edhe planifikimit hapësinor kur jep leje të ndërtimit ju jep edhe leje të rrënit ku do ti deponojnë materialet e ngurta sepse ne po i shohim në teren këto materiale të ngurta nëpër toka bujqësore rreth lumenjve dhe po vjen deri të një degradim edhe i lumenjve pavarësisht pastrimit dhe rregullimit që është bërë për një kohë shumë të shkurtë ka me ardhë deri të mbyllja e shtratit të lumit.

Drejtori i Urbanizmit Petrit Gashi, sa i përket planit lokal të veprimit në mjedis ne kemi adresu edhe në mënyrë sfidat kryesore që merret me menaxhimin e mbeturinave mbrojtjen e tokës ujërave dhe biodiversitetit, këto i specifikon më shumë edhe ligjet edhe udhëzimet administrative që janë në fuqi sa i përket pompave dhe derivateve janë dy leje mjedisore të gjitha ato pompa derivate që kanë kapacitetin deri 50.000 mijë litra i nënshtrohen lejes mjedisore komunale që i kanë të gjitha veprimet në kontrollin e cilësisë së tyre mbi 50.000 mijë litra i kalojnë ministrisë edhe të industrisë tjera shpesh herë kemi adresu probleme sidomos për ndotjen e ajrit në pjesën e Sankocit i adresojmë problemet në ministri, ministria nuk ndërmerr asnjë veprim thotë që cilësia e ajrit është normale dhe shpesh herë i kemi këto probleme me nivelin qëndror.

Liman Krasniqi ju kur ti jepni lejet ndërtimore jeni të obliguar të merrni pëlqim prej ministrisë së planifikimit hapësinor, të çështja e kompletimit të projektit për mos me ardh deri të ndotja e ujërave atmosferikë ju si drejtori duhet me e kërku pëlqimin edhe projektin komplet se çdo pompë e derivateve për me i ik ndotjes se ujit duhet me kërku separatorët që në një kohë kanë qenë rregull edhe ligj, në ligjin e planifikimit edhe ndërtimit por tani janë larguar disa çështje por komuna jonë specifikohet në mënyrë karakteristike sepse të gjitha ujërat atmosferike grumbullohen në lumin Drenica dhe e bëjnë ndotjen e tokave bujqësore, separatorët janë gropa septike që e bëjnë seperimin ndarjen e ujërave fekale që shkojnë ashtu separatorët e bëjnë ndarjen e uljes dhe derivateve me ujin atmosferik, derivatet ngritën në pjesën e sipërme uji me disa pengesa që bëhen në pjesën e poshtme në kanalizimin atmosferik po ulja edhe nafta nuk

lejohen me dal prej atij separatori për atë arsye është mirë që të kërkohen që të mos i ndotim lumenjtë tonë dhe të mos i dëmtojmë tokat bujqësore .

Drejtori i Urbanizmit Petrit Gashi, këto i nënshtrohen ligjeve dhe udhëzimeve administrative që i përcakton niveli qendrorë dhe çdo leje ndërtimore duhet ti nënshtrohet ligjeve dhe udhëzimeve administrative që i përcakton niveli qendror dhe çdo leje ndërtimore duhet ti nënshtrohet ligjeve dhe udhëzimeve administrative e tregova edhe për këtë pjesë i nënshtrohen kur do që aplikojmë për leje ndërtimore normal që duhet të pajisen me pëlqimet e nevojshme

Driton Ajazi, për shkakë të procesverbalit pasi e keni potencuar se disa nga pikat janë kyqe për grantin e performances, ne si grup kuvendar nuk jemi të krijojmë pengës në vlerësim të performances që të ndëshkohemi ne dhe qytetaret e komunës se Drenasit prandaj përtej asaj që kemi pas mungesë të materialit të analizojmë ne i përkrahim pikat e rendit të ditës.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, unë ju falënderoj për bashkëpunimin unë si kryetar e kam obligim për çdo vit me i prodhu këto dokumente dhe me i sjell në kuvend në jemi mundu me i inkorporu të gjitha gjërat me aq sa kemi mundur edhe aq sa kemi ditë, pëlqimet kur i jepim për pompa deri në 50,000 mijë litra jemi të detyruar sepse pa e plotësu formularin nuk mundemi me certifiku për me ja jep certifikatën e lejes të përdorimit, sa i përket mbeturinave ne kemi deponi nuk i dërgojnë e keqja është që shumë kush kur rrënon shtëpi të vjetra hudh mbeturina nëpër prona, ne fatkeqësisht në gjykata aty ku nuk lejohet me u ndërtu shtëpijat që ne i pengojmë e dërgojmë në procedura gjykata e dënon 150 euro 50,100 euro ligji duhet me qenë me i fuqishëm për me mundur me bërë veprime të me tutjeshme ne.

Liman Krasniqi drejtoria kur të lëshon lejen e ndërtimit para se me e leshu lejen e ndërtimit ku ka objekte është e obligueshme me leshu lejen e rrënimit me lejen e rrënimit është e obligueshme me kërku edhe lokacionin e deponis të licencume ose me arsyetu me një vendim ose dëshmi që e dërgon aty dhe nuk e dëmton ambientin, drejtorja e urbanizmit ka mundësi me mbajt nën kontroll nuk ka nevojë me shku në gjykata sepse ky nuk ja lëshon lejen e ndërtimit nëse nuk e dëshmon deponin ku e deponon materialin inert .

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, çdo leje që e lëshojmë po flas edhe në emër të drejtorive sepse ato raportojnë të unë çdo objekt që kërkon dikush me e bër në një pronë të caktume që lejohet, leja e ndërtimit dhe ka objekt të ndertum ka për obligim me kërku lejen për rrënim pastaj me e dërgu në deponi ku e kemi të percaktume si komunë edhe kaq .

Kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi hodhi në votim pikën e pest të rendit të ditës 5.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2025–2029

Për votua 22 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e gjashtë 6. Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit-Komuna e Drenasit 2025-2029

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi pas nuk pati diskutime e hodhi në votim pikë e gjashtë të rendit të ditës Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit-Komuna e Drenasit 2025-2029

Për votua 22 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e shtatë të rendit të ditës 7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi pas nuk pati diskutime e hodhi në votim pikë e shtatë të rendit të ditës 7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën tetë të rendit të ditës 8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Glllogocit 2026–2029

Pas nuk pati diskutime e hodhi në votim pikë e tetë të rendit të ditës 8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Glllogocit 2026–2029

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e nëntë 9. Plani i Reagimit Emergjent (PRE) për Komunën e Glllogocit.

Meqenëse nuk pati diskutime e hodhi në votim edhe pika e nëntë e rendit të ditës .

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën e dhjetë të rendit të ditës 10. Raport për zbatimin e planit të integritetit për komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, diskutime nuk pati raportet nuk votohen dhe vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë 11. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025, e hapi për diskutim por diskutime nuk pati edhe ky raport nuk votohet dhe vazhdojmë me pikën e radhës e cila është pika e dymbëdhjetë 12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026 e hapim për diskutim , pasi nuk pati diskutime vërejtjeje apo sugjerime kryesuesi i kuvendit e hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë 12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026.

Për votua 23 Kundër 0 Abstenim 0

Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën 13. Raporti i vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve të Komunës së Drenasit për vitin 2025. Diskutime nuk pati siç e dim pra raporti nuk votohet dhe kalojmë të pika e 14. Raporti Financiar Janar-Shtator 2025 e hapim për diskutim fjalën e merr:

Egzona Terdevci, i pati dy pyetje të shkurtëra është një gabim deshta me u sqaru a është gabim teknik të faqja e katër e raportit shitja e pasurisë publike është vlere 1 pra d.m.th gjithmonë po mbete kështu se di a është përcjell prapë gabimi i njëjte teknik edhe një hyrje të projekte kapitale në faqen nëntë të ndërtimi i shtëpisë për komunitete vlere e shpenzuar është 229 mijë e 582 euro e 35 cent po me intereson me dit si ka ardh deri të ky shpenzim kur ky tender është anulë me datën 26 gusht pra rrjedhimisht i bjen që nuk ka mundur me pas asnjë shpenzim apo është në përmbarim dhe janë marr mjetet për shkake të përmbarimit.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, përmbaruesi i ka marr rreth 4 milion euro komunës sonë dhe ka dëmtuar shumë në realizimin e projekteve të parapara në komunën tonë. Drejtori i financave Enver Hoxha, kjo është e hyrë e vitit 2024 në 2025–tën nuk është fakturu, vetëm një here është e fakturuar gabimin arkivi e ka bërë


Kryesuesi Kuvendit Komunal Burim Bujupi e hap për diskutim pikën 15. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKS-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025 diskutime nuk pati vazhdojmë me pikën e radhës : 16. Diskutimi i Raportit të Përfornacës Komunale për vitin 2024.

Pasi nuk pati pyetje as diskutime tjera kryesuesi i kuvendit komunal Burim Bujupi e shpalli mbledhjen të mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 13:00


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 24.12.2025 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të <https://www.facebook.com/share/v/1CBLNMqc68/>

Procesmbajtëse:


Fakte Hoti



Kryesuesi i kuvendit komunal Drenas


Burim Bujupi